



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1701/ 7 prot.,

Datë 28 /07/2025

V E N D I M
Nr.961/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Gjergj Mersini	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 28 / 07/2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik "Filara" SHPK në procedurën e prokurimit "Procedurë e Hapur e Thjeshtuar", me Nr. REF-48863-05-23-2025, me objekt: "Blerje adezive për kazane dhe kamionë" me fond limit 2,320,000.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 10.06.2025, nga autoriteti kontraktor ECO Tirana Sh.A.

Ankimues:

Operatori ekonomik "Filara" SHPK, me Nipt. K51611099N Adresa: Rr. Kavajës, Ish kombinati Misto Mame.

Autoriteti Kontraktor:

ECO Tirana Sh.A. Adresa: Rr. Don Bosko, ish parku, Nj. Bashkiake 9, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ndryshuar, Vendimi i

Komisionit të Prokurimit Publik Nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me nenin 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 26.05.2025, është publikuar ne Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit "Procedurë e Hapur e Thjeshtuar", me Nr. REF-48863-05-23-2025, me objekt: "Blerje adezive per kazane dhe kamionë" me fond limit 2,320,000.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar më date 10.06.2025, nga autoriteti kontraktor ECO Tirana ShA.

II.2. Në datën 10.06.2025, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt - ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorezuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, më datë 26.06.2025, autoriteti kontraktor ka kryer vlerësimin e ofertave si vijon:

1. "Filara" shpk	1.740.000	lekë	Skualifikuar
2. "Graphic line -01" shpk	2.092.000	lekë	Kualifikuar
3. "F&M reklama" shpk	2.170.000	lekë	Kualifikuar
4. "Optima communications" shpk	2.200.000	lekë	Kualifikuar
5. "Muça" shpk	0	lekë	Skualifikuar

II.4. Më datë 26.06.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftimin e Fituesit Paraparak.

II.5. Nepermjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankesa e operatorit ekonomik "Filara" ShPK, me numer ankimi elektronik A/2025/5490, datë 28.06.2025, dhe me nr. 1701/2025 prot., datë 30.06.2025, për procedurën e prokurimit "Procedura e Hapur e Thjeshtuar", me REF-48863-05-23-2025, me objekt: "Blerje adezive për kazane dhe kamione" me fond limit 2,320,000.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 10.06.2025, nga autoriteti kontraktor ECO Tirana ShA.

Nga shqyrtimi paraparak i ankesës u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimues "Filara" SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Operatori ekonomik ankimues "Filara" SHPK është skualifikuar me Arsyet e skualifikimit: 2.4.4 *Operatori ekonomik duhet të paragesë moster sipas specifikimeve teknike të cilesuara nga Autoriteti Kontraktor në ditën dhe orën e hapjes së ofertave për artikujt e mëposhtem: - - Adezive për kazan Blu -Adesive për kazan 3750 lt teknologjia e re Mostrat nuk janë në përputhje me ato të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në permasa*

- Adeziv polimerik cast për kazanet blu, Mbeturina të tjera shtepiake me permasat e shkronjave 4 me 4 cm, Logo e Bashkisë Tiranë me permasa 8 me 5 cm dhe permasat e germave 1.5 me 2 cm, Logo e zjarrit me permasa 8 me 8 cm, Logo e Eco Tirana me permasa 8 me 8 cm dhe shkronja 3 me 2 cm Nr tel 04 433 0250 me permasat e numrave 2cm, Logo e facebook email ëeb dhe logo e instagramit me permasa 3 me 3 cm me shkrimin/ Eco_Tirana për instagram facebook mail dhe ëeb me permast e germave 2 cm Logot do të montohen në kazane.*

- Adezive për kazan 3750 lt, polimerik cast me madhësi 133x62cm, printim 1400x1400 dpi, eco solvent, i laminuar me mat i prerë me forme. Sfondi të ketë ngjyrë të verdhë për Letër/Karton, Plastike /Gese, Kanace/Metale. Design duhet të jetë sipas fotos bashkelidhur. Grafiku duhet punuar. Gjithashtu nga verifikimi i bërë nga Autoriteti Kontraktor në mostra e dorezuara nga ana juaj mungonte Adezivi me të dhinat nr. Telefoni, email, Logo e facebook email ëeb dhe logo e instagramit" Argumente nga operatori ankimues: Deshirojme tju sgarojme se në datën dhe në orën përfaqësuesit e autorizuar të shogërise Filara Sh.p.k. janë paraqitur pranë ambienteve të*

AK-se dhe kanë dorëzuar mostrat në perputhje me specifikimet teknik të percaktuara në shtojcen 6 Formulari i Specifikimeve Teknike.

Jemi mjaft të sigurtë që të gjitha mostrat e dorëzuara janë në perputhje me specifikimet teknik, pasi çdo mostër është prodhuar specifikisht për këtë procedurë prokurimi duke ju përmbytur me përpikëmeri specifikimeve teknike dhe kemi bindjen e plotë që asnjë nga pretendimet e autoritetit kontraktor për mos realizimin e saktë të mostrave nuk gjëndron. Nder të tjera, ju sgarojmë se të gjitha mostrat janë paragitur duke përfshirë edhe adezivin me të dhinat nr. Telefoni, email, logo e facebook, email ëeb dhe logo e instagramit.

Gjithashtu, theksojmë se në 20 vite përvijne në këtë fushë dhe mbi 6-7 vite përvijë në fushën e prokurimeve publike nuk kemi asnjë precedent i cili lidhet me mallra që nuk janë në perputhje me specifikimet teknike të percaktuara nga cdo autoriteti kontraktor edhe për kontrata vlera e së cilave është goxha e konsiderueshme, prandaj na duket abusive që mostrat tonë të mos jenë në perputhje me specifikimet teknike të përcaktuar nga Ak Eco Tirana .

Për ta përmbyllur, kërkojmë edhe njëherë verifikim e mostrave të paraqitura në ditën dhe orën e hapjes së ofertave, duke qënë se mostrat e dorëzuara janë në perputhje të plotë me kërkesën e pikës 2.4.4 të shtojcës & seksioni i kriteret e vecanta për kualifikim të mbështetur në specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6 formulari i specifikimeve teknike dhe kërkojmë kualifikimin e ofertës e cila mbi të gjitha është në kushtet e ofertës më të favorshme për Autoritetin Kontraktor.

II.6. Në perputhje me nenin 112 "Veprimet paraprake" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër referencë, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit me Nr. 1701/1 Prot., datë 01.07.2025, në lidhje me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimes "Filara" ShPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.7. Me shkresën ardhur me shërbim postar me Nr.85/12 Prot., datë 01.07.2025, protokolluar me tonën me Nr. 1701/2, datë 07.07.2025, me objekt "Kthim - përgjigje për ankimin e datës 28.06.2025" për Filara ShPK, autoriteti kontraktor ve në dijeni KPP, mbi trajtimin e ankesës së ankimesit, duke vendosur mos pranimin e saj.

II.8. Me shkresën nr. 1701/3 prot., datë 16.07.2025, KPP kërkoi nga autoriteti kontraktor dorëzimin e mostrave objekt - ankimi pranë KPP-së, për të cilat operatori ekonomik "Filara" SHPK është skualifikuar dhe ngre pretendime se mostrat e paraqitura janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST.

[...] Me anë të shkresës Nr.85/12 Prot., datë 01.07.2025, protokolluar me tonë me nr. 1702/2 prot., datë 07.07.2025, institucioni juaj ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion mbi trajtimin të ankesës së operatorit ekonomik ankimes me përmbajtje si vijon: «

Në vijim të shqyrtimit të ankesës suaj të datës 28.06.2025, në lidhje me procedurën e prokurimit "Procedurë e Hapur e Thjeshtuar", me Nr. REF-48863-05-23-2025, ju informojme se Autoriteti Kontraktor ka rivlerësuar mostrat e dorëzuara nga ana juaj. Nga rishqyrtimi Autoriteti Kontraktor vlerëson se mostrat nuk përmbushin kriteret e percaktuara në dokumentet e tenderit. Konkretisht mostrat nuk janë dorëzuar në formatin e kërkuar, siç është percaktuar në dokumentacionin përkatës. Për këtë arsye ankimi juaj nuk pranohet. » Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, krahas informacionit të mësipërm, Komisioni kërkon nga autoriteti juaj të dorëzoni pranë institucionit tonë mostrat për të cilat ankimesi "Filara" SHPK është skualifikuar nga procedura e prokurimit, së bashku me dokumentacionin shogërues të tyre, procesverbalin e mbajtur nga autoriteti kontraktor për administrimin e tyre, dokumentacionin e plotë mbi konstatimin dhe menyrën e vlerësimit të mostrave objekt skualifikimi. Sa më sipër, me gëllim vijimin e gjyqimit të ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik, i gjithë informacioni dhe dokumentacioni i sipërcituar të dorëzohet pranë KPP-së, brenda ditës së nesërme të punës, nga marrja dijeni e kësaj shkrese. /.../

II.9. Me shkresën nr. 1701/4 prot, datë 22.07.2025, protokolluar me , me objekt "Procesverbal i dorëzimit të mostrave, autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë KPP, mostrat dhe dokumentacionin e kërkuar.

II.10 Nga verifikimet e kryera, rezulton, se nuk janë paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik argumente nga subjekte të interesuara lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik , sipas parashikimeve të nenit 113 të ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik".

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor.

Arsyeton

III.1 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "Filara" shpk , mbi vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik me arsye se:

"1. 2.3.1. (Operatori ekonomik Filara është Skualifikuar për arsye si më poshtë: 2.4.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostër sipas specifikimeve teknike të cilesuara nga Autoriteti Kontraktor në ditën dhe orën e hapjes së ofertave për artikujt e mëposhtem: Adezive për kazan Blu, Adezive për kazan 3750lt teknologjia e re. Mostrat nuk janë në përputhje me ato të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në permasat. Adezim Polimerik cast për kazanet blu Mbeturina të tjera shtëpiake me permasat e shkonjave 4 me 4 cm Logo e Bashkisë Tirane me permasa 8 me 5 cm dhe permasat e germve 1.5 me 2 cm, Logo e zjarrit me permasa 8 me 8 cm

Logo e Eco Tirana me permasa 8 me 8 cm dhe shkronja 3 me 2 cm Nr. Tel 044330250 me permasat e numrave 2 cm Logo e facebook email ëëëb dhe bogo e instagramit me permasa 3 me 3 cm me shkrim / Eco_Tirane per instagram, facebook mail dhe ëëb me permast e laminuar me mat I prere dhe forme. Sfondi te kete ngjyre te verdhe per Leter/ Karton, Plastike/Qese, Kanace/ Metale. Design duhet te jete sipas fotot bashkelidhur. Grafiku duhet punuar. Gjithashtu nga verifikimi I bere nga Autoriteti Kontraktor ne mostrap e dorezuara nga ana juaj mungonte Adezivimi me te dhenat nr.Telefoni email, Logo e facebook email ëëb dhe logo e Instagramit)", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1 Në shtojcën 8, pika 2.4.4 "Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit", të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë elektronikisht Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023-2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës limit të kontratës që prokurohet

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim Prodhuesi ose Distributor i Autorizuar.

Ne cdo rast te dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin për ofrimin e pajisjeve objekt të kësaj procedure. Autorizimi nga Prodhuesi duhet të përmbajë kontaktet e plota të prodhuesit (adresë, telefon, e-mail) në rast verifikimi.

2.4.2. Operatori ekonomik duhet te deklaroje se do te dorezoje dhe do te kryeje vendosjen e mallit sipas kerkeses pjesore nga Autoriteti Kontraktor per vendosjen e tyre dhe se adezivet duhet te jene me karakteristiken cast te pershtatshem per t'u vendosur ne kazane metalike, sipas teknologjise Print & Cut dhe me karakteristikat si me poshte:

Fuqia e ngjitesit jo me pak se 15N/25mm

Rezistente ndaj kushteve atmosferike dhe agjenteve te pastrimit.

2.4.3. Operatori ekonomik duhet te disponoje dhe paraqese Certificate ISO 9001:2015 në lidhje me sistemin e menaxhimit të cilësisë ose ekuivalent. Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues te njohur nga RSH.

2.4.4. Operatori ekonomik duhet te paraqese moster sipas specifikimeve teknike te cilesuara nga Autoriteti Kontraktor ne ditën dhe oren e hapjes se ofertave per artikujt e meposhtem:

- Adezive per kazan Blu

- Adezive per kazan 3750lt teknologjia e re

Mostrat e paraqitura duhet te perputhen me specifikimet teknike sipas Shtojces 5 dhe 6. Mosparaqitja ose mosperputhja e mostrave eshte kusht s'kualifikimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

III.1.2. Në përmbushje të kriterit më sipër, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar fizikisht pranë autoritetit kontraktor mostrat të cilat rezultojnë të dorëzuara nga operatorët ekonomik si ne vijim dhe si rrjedhim i këtij fakti autoriteti kontraktor dhe operatori ekonomik kanë mbajtur procesverbalin e me nr. 85/8 prot., datë 10.06.2025 lënda “Procesverbal i marrjes ne dorëzim te mostres”, dokumentacionin i cili rezulton i nënshkruar nga përfaqësuesit e operatorëve ekonomik “FM Reklama”shpk, “Filara” shpk , “Optima Comunnication” shpk , “Graphic Line 01” shpk .

III.1.3 Neni 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik”, parashikon se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet*

operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.4. Neni 3 Parime të përgjithshme 1. *Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.* 2. *Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.* 3. *Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.1.5. Neni 21 Autoriteti ose enti kontraktor 1. *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

III.1.6. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikon shprehimisht se:

“1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

III.1.7 Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 6 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet se:

“6. *Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor*

përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. 38 Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike..”

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike janë lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit.

III.1.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.10. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u

kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe të mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktorë, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues, në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues, i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt - prokurimi.

III.1.11. Referuar legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të kualifikimit dhe të specifikimeve teknike, ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor, për sigurimin e produktit/mallit sa më cilësor, me qëllim realizimin me sukses të kontratës dhe përmbushjen e nevojave. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kritere për kualifikim dhe specifikime teknike, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërejmë se, autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit, ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë ofertues duhet të Operatori ekonomik duhet te paraqese moster sipas specifikimeve teknike të cilësuar nga Autoriteti Kontraktor në ditën dhe orën e hapjes së ofertave për artikujt e më poshtëm:

- Adezive per kazan Blu; -Adezive per kazan 3750lt teknologjia e re

Mostrat e paraqitura duhet të perputhen me specifikimet teknike sipas Shtojces 5 dhe 6. Mosparaqitja ose mosperputhja e mostrave eshte kusht s’kualifikimi, kritere këto, të cilat konsiderohen të përmbushura me dorëzimin e mostrave si dhe gjithashtu mostrat e dorëzuara duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike të parashikuara në shtojcën 5 dhe 6 të dokumentave standarte të tenderit.

Nga verifikimi i dokumentacionit në SPE si dhe nga verifikimi i mostrave të dorëzuar fizikisht nga autoriteti kontraktor, mostrave të cilat i përkasin operatorëve ekonomik të cilat janë depozituara pranë autoritetit kontraktor në përmbushjen të kritereve të mësipërm të sipërmendura si dhe referuar raportit të auditit në SPE, Komisioni konstaton, se nga ana e KVO-së nuk janë dhënë shpjegime në mënyrë shteruese, lidhur me mospërmbushjen e elementëve të secilit parametër të specifikimeve teknike të sipërpërmendura. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimes, arsyes së skualifikimit të dhënë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, referuar raportit të auditit në SPE, si dhe dokumentacionit të operatorit ekonomik “Filara” shpk , të dorëzuar në SPE, në përmbushje të kritereve të kualifikimit të mësipërme, Komisioni gjykon

se, është në kushte të paqarta dhe në pamundësi për të vlerësuar mbi arsyet e skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor, konkretisht në vlerësimin e dhënë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, sepse ky i fundit nuk ka dhënë apo evidentuar qartë se cili parametër nuk përmbushet nga modeli i artikujve të ofruar nga operatori ekonomik ankimues referuar kjo specifikime teknike të hartuara sipas përcaktimeve të shtojcës 6 (specifikimet teknike) të DT, duke e vënë në një pozitë jo të qartë, konfuze dhe jo të argumentuar qartë.

Në këto kushte, Komisioni gjykon se, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të rikthejë procedurën e prokurimit objekt ankimi, statusin e fazës së rivlerësimit, dhe secili anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave duhet të evidentojë qartë dhe saktë, se cili parametër/specifikimi teknik konkret, nuk përmbushet nga artikujt/modelet e ofruara nga ankimuesi të specifikimeve teknike të përcaktuar nga vetë autoriteti kontraktor.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 *“Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

- 1.Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "Filara" SHPK në procedurën e prokurimit "Procedurë e Hapur e Thjeshtuar", me Nr. REF-48863-05-23-2025, me objekt: "Blerje adezive për kazane dhe kamionë" me fond limit 2,320,000.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 10.06.2025, nga autoriteti kontraktor ECO Tirana Sh.A.
- 2.Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi për operatorin ekonomik "Filara" SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër.
- 3.Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
- 4.Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "Filara" SHPK
- 5.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

6.Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

